

Në pajtim me nenin 26- nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal (Gaz.Zyrtare 63/2007, 187/2013, 43/2014, 215/2015 dhe 64/2018) dhe në bazë të nenit 12 nga Vendimet e themelimit të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Udhëheqësja e Qendrës e dorëzon këtë

RAPORT FINANCIAR

për punën e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019

1.Themelimi dhe qëllimet e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor

Qendra për zhvillim rajonal u themelua nga 9 (nëntë) njësitë e qeverisjes vendore të cilat janë pjesë e rajonit planor Jugperëndimor. Qendra për zhvillim i përmbaron punët administrative dhe profesionale për Këshillin për zhvillim, të cilat janë me rëndësi për zhvillimin e rajonit planor Jugperëndimor, përkatësisht në drejtim të realizimit të objektivave dhe parimeve të politikës së zhvillimit të barabartë dhe të qëndrueshëm.

2.Burimet e financimit

Në pajtueshmëri me nenin 27 nga Ligji për zhvillim të barabartë rajonal, të hyrat e financimit për aktivitetet dhe programet e punës të Qendrën për zhvillim rajonal realizohen nga burimet në vijim:

- Buxheti i Republikës së Maqedonisë
- Buxheti i NJVL
- Fondet nga Unioni Evropian
- Burime tjera ndërkombëtare
- Donacionet dhe sponzorimet nga individët dhe subjektet juridike
- Mjete të tjera të përcaktuara me ligj

3.Realizimi i Planit financiar

Në bazë të qëllimeve të përcaktuara dhe burimeve të të hyrave të përcaktuara me ligj, duke duke u nisur nga programet dhe nevojat për funksionim pa pangesa të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, Këshilli për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor e miratoi Planin Financiar për punën e Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor për vitin 2019, në seancën e mbajtur më __.03.2020.

Në raportin financiar janë paraqitur të dhënat nga tre llogaritë e Qendrës për zhvillim, nga të cilat njëra është themelore dhe dy nën llogari të cilat u hapën për projekte nga donatorët. Për çdo llogari janë përgatitur llogari përfundimtare të veçanta për vitin 2019 dhe të njëjtat janë dorëzuar deri te Regjistri qendror i RMV në afatin e përcaktuar ligjor.

3.1 Të hyrat

Të hyrat e planifikuara i kushtohen periudhës nga 01.01.2019 deri në 31.12.2019 dhe ishin të përcaktuara në lartësinë prej 86.489.350 denarë.

Në periudhën prej 01.01.2019 deri në 31.12.2019 janë realizuar të hyra në vlerë prej 81.605.951 denarë, nga të cilat 74.949.458 denarë në llogarinë themelore të Qendrës, ndërsa në nën llogarinë e projektit nga donatorët “Zgjidhje inovative për qasje më të mire deri te shërbimet në nivel lokal – Biznes qendra” 352.055 denarë, dhe në nën llogarinë e dytë donatore “Zhvillim i barbartë rajonal I qëndrueshëm dhe inkluziv” në vlerë prej 6.304.438 denarë.

Realizimi i të hyrave e shprehur në përqindje është 94,35% nga të hyrat e planifikuara me Planin financiar për vitin 2019. Vlera e mjeteve të bartura nga buxheti i 2018 në buxhetin e vitit 2019 në llogarinë themelore është 28.078.251 denarë, ndërsa në nën llogarinë e projektit “Zgjidhje inovative për qasje më të mire deri te shërbimet në nivel lokal – Biznes qendra” është 352.055 denarë, ndërsa nën llogaria e dytë “Zhvillim i barbartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” është hapur në vitin 2019 dhe për atë shkak nuk ka mjete të bartura.

Pjesa më e madhe e të hyrave të planifikuara i kushtohen projekteve me të cilat Qendra për zhvillim aplikoi tek donatorë të ndryshëm. Për fat të keq tek shumë thirrje

procedurat e vlerësimit janë prolonguar ashtu që nuk ka pas rezultate dhe nuk janë nënshkruar kontratat deri në fund të vitit kalendarik.

Në pajtim me Marrëveshjet e veçanta të nënshkruara në mes Komunave dhe Qendrës për zhvillim të RPJP deri në fund të vitit 2019, janë realizuar të hyra si kontribut vetanak i komunave në projektet rajonale të financuara nga programet nacionale dhe projektet e donatorëve në vlerë prej 5.100.078 denarë. Ngelin edhe 4.120.775 denarë që të paguhen nga ana e komunave.

Me rëndësi është të theksohet se në raport me të hyrat e planifikuara për punën vijuese të Qendrës në bazë të transfertave nga buxhetet e NJVL të cilët participojnë në rajonin planor Jugperëndimor dhe MVL, janë realizuar 45,66% nga të planifikuarat ose e thënë në vlerë nominale nga të planifikuarat 11.250.283 denarë, janë realizuar vetëm 5.137.040 denarë.

3.2 Shpenzimet

Për shkak të devijimit të të hyrave të planifikuara dhe të realizuara, reflektohet edhe disariteti i paraqitur i shpenzimeve të përcaktuara me Planin financiar dhe shpenzimeve të realizuara.

Në vitin 2019 janë realizuara shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 49.717.430 denarë nga të cilat 43.741.621 denarë nga llogaria themelore, nga nën llogaria “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” (SDC-MVL) 5.623.754 denarë nga nën llogaria e projektit të donatorëve “Zgjidhje inovative për qasje më të mire deri te shërbimet në nivel lokal – Biznes qendra (UNDP)” janë realizuar shpenzime në lartësi prej 352.055 denarë.

Të paraqitura në strukturë shpenzimet janë realizuar për harxhimet e mëposhtme:

- për shpenzime kapitale përkatësisht aktivitete të projekteve në kuadër të projekteve rajonale të siguruara në vitin 2019 nga burime buxhetore dhe donatorë, janë shpenzuar 38.758.391 denarë ose 77,96% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

- për rroga, kontribute, dhe tatime për të punësuarit në Qendër janë realizuar shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 2.889.835 denarë ose 5,81% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

- për shërbime komunale, komunikim, transport dhe shpenzime rruge janë realizuar shpenzime në vlerë të përgjithshme prej 280.138 denarë ose 0,56% nga shpenzimet e përgjithshme.

- për shpenzime tjera rrjedhëse janë harxhuar 250.670 denarë ose 0,50% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

- për shërbime tjera kontraktuale të ndërlidhura me punën vijuese të Qendrës (mbikëqyrje, konsulent, higjiena, kontabilitet, kopjim dhe botim, përkthim, lektorim) dhe me realizimin e aktiviteteve të projekteve nga nën llogaritë e donatorëve (trajtime, forume, punëtori) janë realizuar 1.535.692 denarë ose 3,08% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

- dhe për materiale dhe inventar të imët për riparime dhe mirëmbajtje janë shpenzuar 134.841 denarë ose 0,27% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

- për transferim të ndërlidhura me kthimin e mjeteve në buxhetin nacional dhe pagesa pas korigjimeve janë shpenzuar 5.863.867 denarë ose 11,79% nga shpenzimet e përgjithshme në vitin 2019.

4. Detyrimet e Qendrës

Në pajtim me Ligjin për kontabilitet për buxhetet dhe shfrytëzuesit buxhetor nuk zbatohet plotësisht parimi i harmonizimit të angazhimeve dhe pagesës së njëjtë në vitin aktual buxhetor. Qendra për zhvillim detyrimet e krijuara për punën vijuese, projektet rajonale të realizuara në vitin 2019 dhe detyrimet nga projekti i donatorëve “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” nuk I ka realizuar në tërësi me çka ka bartur detyrime në vitin vijues në shumë prej 10.902.279 denarë, si dhe detyrimet e pa realizuara duke përfshirë datën 31.12.2019. Nga shuma e përgjithshme e përmendur e detyrimeve 10.311.623 denarë janë nga llogaria bazë për realizimin e aktiviteteve të projekteve, dhe shpenzime për punën vijuese, ndërsa nga projekti i donatorëve 590.656 denarë.

5. Kërkesat

Kërkesat e përgjithshme duke përfshirë datën 31.12.2019 në pajtim me evidencën kontabilistike janë 9.732.762 denarë. Në këtë vlerë janë kalkuluar mjete nga Komunat për punën vijuese të Qendrës në vlerë prej 5.611.987 denarë, për kontribut vetanak të Komunave në projekte rajonale në vlerë prej 4.120.775 denarë.

Në pajtim me Ligjin për zhvillim të barabartë rajonal dhe Vendimet për themelim të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, detyrim është që çdo Komunë të participojë për punën vijuese të Qendrës për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor në shumë prej 10 denarë për banor. Sipas parametrave të përcaktuara, por edhe në pajtim me Marrëveshjet për kofinancim të Qendrës për periudhën 2009 deri në 2019, nënshkruar ndërmjet Ministrisë për vetëqeverisje lokale dhe komunave në përbërje të rajonit planor Jugperëndimor, dhe në pajtim me Vendimet për themelim, për vitin 2019 për këtë qëllim Qendra duhej të realizojë të hyra të përgjithshme në vlerë prej **11.250.283** denarë. Nga të hyrat e planifikuara për këtë qëllim duke përfshirë datën 31.12.2019 janë realizuar gjithsej 5.137.040 denarë, dhe ajo është në bazë të pagesave të komunave dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale.

Duke përfshirë datën 31.12.2019, vetëm një komunë (Qendër Zhupa) në tërësi I ka shlyer detyrimet për punën vijuese të Qendrës për zhvillim të RPJP. Njëra komunë (Pllasnica) për periudhën 2009-2019, në asnjë rast nuk ka paguar mjete për punën vijuese të Qendrës. Në vitin 2019 shtatë komuna kanë paguar jete për punën vijuese të Qendrës për zhvillim ndërsa dy komunat e tjera (Pllasnica dhe Dibra) nuk kanë paguar asgjë.

6. Projekte nga donatorët

Në vitin 2019 përfundoi realizimi I aktiviteteve të projektit “Zgjidhje inovative për qasje më të mire deri te shërbimet në nivel lokal”- Aktivitet për themelimin e Biznes Qendrës për përkrahje dhe shërbime konsulente për ndërmarrjet e vogla dhe të mesme në rajonin planor Jugperëndimor. Nga nën llogaria numër 880006121278520, është bërë një transaksion dhe me atë llogaria është sjellë në 0, dhe për ato shkaqe e njëjta është mbyllur në mars të vitit 2019. Në vitin 2019 filluan aktivitetet e projektit “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv” dhe për të njëjtin u hap nën llogari me numër 880006121278553. Prej kësaj llogarie janë kryer transaksione për aktivitetet e realizuara në kuadër të projektit. Në pjesën e pare të këtij raporti janë të

përfshira të gjitha ndryshimet në këtë llogari. Detaje për realizimin e aktiviteteve të projektit janë dhënë në Raportin për realizimin e Programit për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor, dhe në Raportin e punës së Qendrës për zhvillim të RPJP për vitin 2019.

7.Furnizimet publike

Në periudhën prej Janar deri në Dhjetor të vitit 2019 Qendra për zhvillim të rajonit planor Jugperëndimor përgatiti 17 furnizime publike nga të cilat 13 furnizime publike janë realizuar në përgjithësi, ndërsa 3 furnizime janë shpallur për here të dytë dhe janë realizuar, ndërsa 1 furnizim publik është shpallur dhe realizuar për here të tretë. Nga numri i përgjithshëm – 16 janë me procedure të thjeshtë të hapur, ndërsa njëra me Kërkesë për grumbullim të ofertave.

Nga furnizimet publike të realizuara 16 janë të lidhura me implementimin e projekteve rajonale dhe vetëm një për punën vijuese të Qendrës për zhvillim. Vlera e përgjithshme e marrëveshjeve të nënshkruara për të gjitha furnizimet është **61.300.000** denarë me TVSH të përlllogaritur. Furnizimet janë të realizuara në formë elektronike përmes Sistemit elektronik për furnizime publike të Byrosë për furnizime publike, dhe të gjitha kanë përfunduar me ankande elektronike.

Përveç këtyre, në pajtim me Rregulloren e donatorit për realizimin e një pjese të aktiviteteve nga projekti “Zhvillim i barabartë rajonal i qëndrueshëm dhe inkluziv”, e financuar nga ana e Agjencionit zviceran për zhvillim dhe bashkëpunim dhe Ministrisë për vetëqeverisje lokale janë realizuar tre furnizime për organizimin e forumeve rajonale, angazhim të moderatorit për forumet dhe për organizimin e konferencës ndërkombëtare. Shuma e përgjithshme e marrëveshjeve është 700.000 denarë.

Përcaktim më të afërt të hyrave sipas burimeve dhe qëllimit të shpenzimeve sipas shfrytëzuesve dhe zërave është dhënë në llogarinë vjetore.

Strugë, 27.02.2020

Qendra për zhvillim të
rajonit planor Jugperëndimor
Udhëheqësja
M-r Mirjana Lozoska